



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 70

Prishtinë, më 18.5.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Zulfi Merxha, Heset Cakolli, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Ali Lajçi, Zef Morina.

Munguan : Branislav Grbić, Naser Rugova, Berat Luzha, Myrvete Pantina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga ZRRUM (Raif Preteni-drejtor), MBPZHR-Shefki Zeqiri, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naim Maloku**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 11.5.2010,
3. Raporti i ZRRUM,
4. projektligji,
5. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 11.5.2010

Nënkryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Raporti nga ZRRUM

Naim Maloku dhe anëtarët tjerë të komisionit përshëndetën dhe uruan Raif Pretenin-drejtor për detyrën në këtë post bashkë me zëvendësin e tij Kero Bardhi, duke sugjeruar që së pari të raportojnë gojarisht pastaj parashtrohen pyetjet nga komisioni. **Elheme Hetemi** sugjeroj që të

emëruarit ti dërgojnë komisionit plan-programin e menaxhimit të rregullatorit si mendojnë të ndryshojnë gjendjen aktuale për së miri, pasi që nuk i takojnë periudhës raportuese.

Komisioni përkrahu sugjerimin e kryesuesit që të veprohet si zakonisht : raportimi gojor, pyetjet e anëtarëve, në fund rekomandimet e komisionit për seancë.

Drejtori i rregullatorit me bashkëpunëtorët (Ramiz Krasniqi dhe Qamil Musa) njoftuan komisionin më përfaqësues sesa që është shkruar në raportin me shkrim (e dyta me radhë), ngase dy eprorët e cekur kanë filluar punën gjatë këtij viti pasi që janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës. Ai tha se rregullatori siç dihet është autoritet i pavarur që rregullon veprimtarinë e kompanive publike të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë. Kjo zyre gjatë vitit 2009 ka vazhduar të përforcojë funksionet e veta rregullatore në fushat : institucionale, sistemi të monitorimit dhe vlersimit të performancës së kompanive, avansimit të procesit tarifar dhe bashkëpunimit me palët e interesit. Në planin e bashkëpunimit me vendet tjera, ZRRUM bashkëpunon me homologët nga Shqipëria (me të cilin është nënshkruar marrveshja), Skotlanda dhe Portugalia. Kjo zyre ka përcaktuar tarifat e ofruesve të shërbimeve për 3 vjetët e ardhshme, jap licencat për ofruesit e shërbimeve, mbron interesat e konsumatorëve duke mbrojt nga pozita e monopolit të ofruesve të shërbimeve, përcakton procedurat e shkyqjeve individuale dhe kolektive të konsumatorëve nga rrjeti i ujësjellësit etj. Ujësjellësi për tre vite ka arkëtuar 23 milion të planifikuara duke përmirësuar interesin e konsumatorëve. Ai në fund tha se ky raport me siguri do të plotësohet nga takimi i sotëm me anë të sqarimeve ngase është e pamundur të përfshihen të gjitha aktivitetet e zyrës me një raport me shkrim.

Heset Cakolli pyeti për komunat si do të realizojnë angazhimin për biznese dhe si do të realizohen projektet për të ndaluar ujin e ndotur për pije. **Elheme Hetemi** pyeti për deponin në Gjilan e cila paraqet rrezik për atë rajon për shkak të defektit teknik si dhe për faturimin më kualitativ-efektiv, gjithashtu shprehu brengën për liqenin e Batllavës e cila ende është pronë e KEK-ut, çka nëse mbetet kështu, a do të rrezikohet popullata në aspektin e ujit të pijshëm. **Zef Morina** pyeti si do të luftohet mosefikasiteti, sidomos në inkasim. **Naim Maloku** lavdëroi raportin dhe pyeti për kompanit me performanca të trendit negativ, si do të veprohet me ata, a koordinon punët kjo zyre me MMPH sa i përket strategjisë për mbeturina, a janë krye analizat për tarifat e mbeturinave dhe a ka vendim për tarifa, çka mundet ky komision me ndihmua si Kuvend p.sh. komunat të marrin përgjegjësinë për inkasim, ngase inkasimi vullnetar nuk qon askund, si punojnë kompanitë private, si licencohen. Ai kërkoi nga kjo zyre çfarëdo ideje nëse kanë të parashtrorjnë deri në mbledhjen e radhës.

Duke u përgjegjur në pyetjet e parashtruara, zyrtarët e ZRRUM konstatuan si vijon :

- me rastin e shqyrtimit të strategjisë për mbeturina, askush nga kjo zyre nuk është ftuar nga MMPH,
- lidhur me licenca MMPH lëshon disa sosh me çka anashkalohej kjo zyre dhe krijohen mosmarrveshje në mes këtyre dy institucioneve, shpresohet që ligji i ri do ti anashkaloi këto gjëra,
- problemet e kompanive për mbeturina-zgjedhja e problemit qëndron tek veprimi i inspekcioneve komunale,
- inkasimi do të rregullohet vetëm nëse nënshkruhet marrveshja konsumator-kompania, me çka krijohet baza për obligim të konsumatorit për të paguar,
- ZRRUM ka nxjerr rregulloren për kontraktimin e kompanive private për shkak të mosinvolvimit të sektorit privat,
- borxhet e kompanive të ujësjellësit do të zbuten poçes analizohen praktikatat e gjertanishme të faturimit sipas numrit të anëtarëve të familjes dhe ujëmatësve (**Elheme Hetemi** insistoi për mundësin e faturimit nga ana e komunave për shkak të mekanizmave për detyrime).

Në vazhdim **Zylfi Merxha** shprehu pakënaqësinë me punën e kompanive për mbeturina, ndërsa **Selvie Halimi** kërkoi sqarim si do të realizohet paralajmërimi nga ujësjellësi për shkyqje për shkak të borxheve, a do të pësojnë edhe ata që paguajnë, pse dikush paguan më pak e dikush më tepër, pse nuk aplikohet leximi i ujëmatësve, pse të paguajnë pakica njësoj si

shumica, trajtimi i bizneseve (katet e para të ndërtesave) dhe shumë paqartësira tjera. Përfaqësuesi i ZRRUM përveq që ceku se janë mbështetur vetëm tri kërkesa për shkyqje kolektive në Prishtinë (ku nuk kanë paguar 51 nga 100), nuk kishte ndonjë sqarim të sakt se si duhet të veprohet, por shpresoi se do të ndihmoi Kuvendi deri në miratimin e ligjit të ri për mbeturina.

Komisioni nuk miratoi arsyetimin e zyrtarit të ZRRUM se nuk ka mundësi për vendosjen e ujëmatësve në çdo banesë (propozues **Zef Morina**).

Komisioni nxori :

K O N K L U D I M

Në mbledhjen e radhës komisioni do të rekomandoi seancës plenare lidhur me raportin e ZRRUM për vitin 2009 duke pasur parasysh konstatimet nga takimi i sotëm me përfaqësuesit e rregullatorit për ujëra dhe mbeturina, duke kërkuar :

- instalimin e ujëmatësve nëpër secilin banesë veq e veq,
- sipas ligjit që rregullon hapësirat e përbashkëta dhe harxhimit kolektiv të gjendet solucioni më real për inkasimin e ujit të pijshëm nga konsumatori, dhe
- të mundësohet realizimi i kërkeve nga ZRRUM lidhur me shqetësimet e tyre që do ti dërgohen komisionit deri në mbledhjen e radhës.

4. Projektligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore

Nënkryetari **Naim Maloku** fillimisht propozoi të dëgjohen arsyet e shtyerjes së miratimit edhe të dy amendamenteve për mbledhjen e sotme, për çka zyrtari i ZRRUM japi sqarimin se kjo zyre nuk ka të bëjë me problemin e ujit për ujitjen e tokave, në bazë të cilit informatë komisioni konstatoi se dy amendamentet mbeten ashtu si janë formuluar :

Amendamenti 6

Neni 7 – riformulohet në fillim : “**Neni 6 i shtohet paragrafi 6.5 me tekstin si vijon:**”.

Amendamenti 9

Neni 24, riformulohet si vijon :

“Te Neni 30 në reshtin e 2 pas “shoqatave” shtohet “**dhe shfrytëzuesve tjerë**”, ndërsa në vazhdim të reshtit fjala “përcaktuara” bëhet “**propozuara**”. Në fund të tekstit të këtij neni shtohet :”**Bordi mbikëqyrës aprovon tarifat për furnizim për ujitje**”.

5. Të ndryshme

- **Naim Maloku** njoftoi komisionin se lidhur me vizitën e komisionit në Bruksel nga kryetari i komisionit është sugjeruar të vendoset për çështjet e kërkuara me shkresën e përfaqësueses së KE Iva Stamenova, ndaj komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Prej datës 31 maj deri 4 qershor 2010 në Bruksel udhëtojnë : **Naser Rugova, Naim Maloku, Zylfi Merxha, Heset Cakolli, Elheme Hetemi, Ali Lajqi** me mbështetjen financiare të zyrës së Komisionit Evropian-përfaqësia në Prishtinë, ndërkaq **Bajram Badivuku**, mbështetje nga srafi, do të udhëtoi me shpenzimet e Kuvendit.
2. Anëtarët e delegacionit që nuk kanë viza, duhet menjëher të dorëzojnë pasaportat me dy foto tek administratori i komisionit ku do të nënshkruajnë aplikacionet, ngase vizat poashtu do të sigurohen me mjete financiare të Kuvendit.

3. **Kërkesa për kryesi i dërgohet menjëher divizionit për protokoll, njëherit kërkohet veprim adekvat nga sekretari i Kuvendit për realizimin e vizitës në bashkëpunim me kryetarin e Kuvendit, për shkak se data e udhëtimit është afër.**

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,15.

Nënkryetari i Komisionit,
Naim Maloku